



Buletin Informativ

Maj 2020

SHOQATA KOMBËTARE E GRAVE PROFESIONISTE, AFARISTE E ZEJTARE TË SHQIPËRISË

NË KËTË NUMËR

Buletini i 100-të i SHGPAZ dhe COVID-19!

Editorial nga Tefta Demeti

Numri i 100 i buletinit të SHGPAZ e gjen sipërmarrjen femërore në një gjendje ekonomike pothuaj të asfiksuar. SHGPAZ për rreth 30 vjet ka mbrojtur interesat e këtij grupimi dhe ka qenë zëri dhe përfaqësimi i sipërmarrjes femërore në të gjitha institucionet vendimmarrëse brenda dhe jashtë vendit. Aktivitetet e kësaj shoqate janë prezantuar denjësisht në buletin elektronik mujor që publikon SHGPAZ, cilësia e të cilit është përmirësuar vazhdimisht dhe në këto 18 muajt e fundit publikohet gjithashtu edhe në anglisht me mbështetjen e projektit të financuar nga BE për "Nxitjen e sipërmarrjes dhe të mësuarit për sipërmarrjen tek të Rinjtë dhe Gratë në Shqipëri". Situata e mbylljes ekonomike gjatë periudhës 2-mujore të izolimit total të vendit ka rënduar si gjendjen e sipërmarrëseve të mëdha dhe të të punësuarve të tyre ashtu edhe gjendjen e artizaneve, të biznesit familjar dhe të të vetëpunësuarve. Së pari ju urojmë të gjithëve

shëndet të mirë, durim dhe mendje të mprehtë për të rifilluar aktivitetin ekonomik mbase në një stad tjetër. Duke pasur parasysh se numri i sipërmarrjeve me pronare/administratore gra është ulur nga viti në vit dhe të dhënat më të fundit të INSTAT tregojnë se ato përbëjnë vetëm 25,7% të të gjithë bizneseve aktive për vitin 2018, shifër që është 2 pikë përqindje më e ulët se ajo e vitit 2013 prej 27,7%, tregon se klima e biznesit për sipërmarrjen femërore këto vitet e fundit është përkeqësuar. Sado që të flasim ne apo mbështetja minimale ose hiç fare nga qeveria, barra e rëndë bie mbi vetë sipërmarrësit. Besojmë tek aftësitë sipërmarrëse të grave, por sugjerojmë që edhe qeveria nga financimet e donatorëve apo buxheti i shtetit, të hartojë paketa konkrete mbështetëse dhe të përkrahë fuqishëm sipërmarrjen në përgjithësi, por atë femërore dhe artizanet edhe më shumë.

Ecuria e Sipërmarrjes Femërore Në Shqipëri

Sipas studimit më të fundit të SHGPAZ, për ecurinë e zhvillimit të sipërmarrjes femërore në Shqipëri.. **F.3**



Dita Botërore e Sklerozës Multiple

Dita Botërore e Sklerozës Multiple (SM) përfaqëson fushatën vjetore për rritjen e ndërgjegjësimit... **F.9**



Nesër do të thotë kurrë

Nga Flutura Xhabija

Në genin e gruas siç duket ka një „sustë nxitëse“ që kurrë nuk thotë „jo“ dhe nxiton për t'i mbaruar punët mirë e në kohë, por... bën edhe atë, që mund të bëhet Nesër; kuptohet që kjo „shqisë“ ka brenda pavarësi, inteligjencë dhe dashuri pa kushte; në të gjitha kohërat edhe në lashtësi tek papiruset dhe librat e shenjtë, shkruhet se gruaja ka vlera të mëdha, jo më kot, e jo vetëm si riprodhuese jete. Ajo punon e heshtur dhe nganjehere flet vetëm... kur kërcënohet familja, shoqëria, kombi dhe bota.

Sidomos në kohë luftrash e trazimesh, kontributi i saj është i paçmueshëm dhe shpesh i padiskutueshëm. Le të bëjmë një analizë të vogël (pa pretenduar se diç është, por thjesht një mendim dhe përvojë e imja).

Ku ishte dhe është pozicioni i gruas në të gjitha sferat, në këtë periudhë; po filloj nga lart e pastaj më poshtë sipas fushave. **Së pari**, Gratë lidere në vendet respektive, treguan qartë se ato bënë zgjidhjen më të mirë në përballjen me virusin; **Së dyti**, në shëndetësi shërbimi parësor dhe sidomos dytësori kishte mijëra punonjës shëndetësorë, gra që luftuan e po luftojnë maksimalisht - jo vetëm për pagesën - por përkushtimin dhe ndjeshmërinë e lartë njerëzore; **Së treti**, stafi arsimor ku 90 % punojnë gra, i cili përballoi vështirësinë e të dhënit mësim, pa pasur trajnim specifik dhe teknologji digjitale të mirë, me një pagë modeste dhe me ngarkesa të tjera didaktike. **Së katërti**, në

sektorin e informacionit dhe komunikimit, një shtyllë e shoqërisë elektro-

nike, gratë në epokën digjitale zbuluan një aftësi në tregun e punëve digjitale, duke përgatitur materiale të besueshme dhe shumë profesionale në fushat institucionale, private dhe publike, ato po ndihmojnë njerëzit të manaxhojnë jetën e tyre edhe në internet, me një infrastrukturë të mirë dhe aftësi të duhur. Prandaj BE dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare prestigjioze po mbështetin posaçërisht gratë në tre fusha: arsim, sipërmarrje, hulumtim & inovacion, gjithashtu po marrin masa kundër dhunës gjinore. **Së pesti**, Gratë në fason po punojnë nën hundën e Covid-it mortal, në kushte jo shumë të favorshme pune; **Së gjashti**, roli i masmediave, mbushur me gratë gazetare edhe pse të rrezikuara nuk linin vend a skutë për të ndihmuar e përçarur lajmin e saktë e të vërtetë publikut të tronditur nga kjo murtajë e papritur.

Së shtati, gratë në bujqësi nuk po lënë tokë pa punuar e pa mbjellur me produkte të stinës, për të mbajtur tregun urban me të gjitha prodhimet e nevojshme të përditshme, por edhe ato kurative; **Së teti**, i fundit për këtë shkrim, gratë artizane nuk pushuan së punuari në shtëpi dhe në dyqan, edhe pse pa klientë, por përgatitën mallrat për **Nesër**; së shpejti vjen hapja, dhe Gratë janë gati të përballojnë dëmet, vonesat, sfidat dhe ndryshimet e mëdha të jetesës, të tregut dhe të marrëdhënieve njerëzore. Kjo vjen nga ajo shqisë që ne përmendëm sa sipër. Ka shumë fusha të cilat nuk po i



përmend, por asaj fushe që i takoj edhe unë, biznesit femëror, të grupuara në SHGPAZ, janë pronuar, edhe pse asnjëherë të mbështetura, sigurisht vetëm me propagandë; biznesi i grave, mikro dhe i vogël, ka vuajtur e po vuan mjaft, edhe nuk është ndërprerë asnjëherë nga ato.

Shoqëria civile, jo ajo me mbështetje politike, nuk i është ndarë komunikimit me anëtarët, partnerët dhe bashkëpunëtorët; si shoqatë kemi punuar maksimalisht me publikun tonë, me institucio-net shtetërore, me dhomat e tregtisë, me partnerët e huaj dhe me organizatat ndërkombëtare.

Gratë janë në front të parë tani dhe besoj do të jenë edhe pas Covid-it, me arsyen se tani drejtuesit po i kërkojnë në tavolinat e tyre të diskutimit, në vendimmarrje, po i besojnë stilit të grave dhe po mësojnë nga ato; megjithatë, për të mos e bërë rozë, ky është fillimi i ndreqjes natyrore të balancës gjinore.

Mediat e huaja, nga më të famshmet, me nuhatje afatshkurtër dhe afatgjatë, po mbështesin fort këtë evolucion social të kapaciteteve femërore, duke ndryshuar klishetë në dobi të përmirësimit të administrimit, kulturës dhe shoqërizimit të botës.

ECURIA E SIPËRMARRJES FEMËRORE NË SHQIPËRI

Nga Tefta Demeti

Ndërmarrjet mikro, të vogla ose të mesme (SME-të) janë shtytësi kryesor i rritjes ekonomike në Shqipëri si dhe i krijimit të vendeve të punës. Përfshirja e grave në biznes është një potencial i cili duhet të shfrytëzohet për rritjen më tej të ekonomisë së vendit ashtu si edhe vetë-punësimi dhe fuqizimi ekonomik i grave. Gratë sipërmarrëse në Shqipëri përballen me shumë sfida; jo vetëm ato me të cilat përballen sipërmarrësit meshkuj, por edhe faktorë të tillë si paragjykimet sociale dhe mentaliteti, veçanërisht në zonat rurale.


Sipas INSTAT 2019¹, gratë manaxhojnë / zotërojnë 25,7 % të bizneseve totale aktive të vitit 2018, krahasuar me 29,7 % gjatë vitit 2017 me një rënie prej 4 pikë përqindje. Qarku i Tiranës ka edhe përqendrimin më të madh të bizneseve të drejtuara nga gratë, me 41,4 %. Bizneset e drejtuara nga gratë janë kryesisht biznese me 1-4 të punësuar, të cilat zënë 91,2 % të numrit të përgjithshëm të bizneseve të drejtuara nga gratë. Megjithatë, gratë drejtojnë

19,6 % të bizneseve me 50 e më shumë të punësuar. 84% e tyre manaxhojnë aktivitete shërbimi dhe shumica në tregti dhe 86.7% e bizneseve kanë formën ligjore si person fizik. Ecuria e numrit të bizneseve të drejtuara nga gratë në vite tregon se kemi një rritje të pjesëmarrjes së tyre në biznes nga viti 2005 deri në vitin 2015 ku ka arritur kulmin me 31,3% dhe më pas kemi një reduktim të ndjeshëm nga viti në vit deri në 25,7% në vitin 2018. Kjo vlerë është 2 pikë përqindje më e ulët se ajo e vitit 2013 (27.8%). Gjithashtu edhe numri i grave sipërmarrëse është reduktuar nga 47,706 në vitin 2015 në 41,825 në vitin 2018, pra me rreth 12,3%.

Sipas qarqeve rënia më e madhe e pjesëmarrjes së grave në biznes vihet re në qarkun e Beratit nga rreth 28% në 2013 në 18% në 2018, më pas vjen Fieri nga rreth 27% në 2013 në 19% në 2018, dhe Korça nga 26% në 2013 në 18% në 2018. Nga viti 2015 ka filluar regjistrimi i fermerëve me NIPT dhe përfshirja e tyre në Regjistrin e tyre në Regjistrin e biznesit të INSTAT,


në grupin e bizneseve me 1-4 të punësuar. Numri i grave fermere të regjistruara në vitin 2018 rezultoi se përbën 10% të të gjithë fermerëve të regjistruar me një ulje me 3,7 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017, por me një rritje prej 2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015.

Në reduktimin e numrit të bizneseve të drejtuara nga gratë ka ndikuar përkeqësimi i klimës së



biznesit në Shqipëri që është pasqyruar edhe nga raporti i Bankës Botërore "Doing Business" ku Shqipëria në vitin 2016-2017 renditej në vendin e 58-të me 68.9 pikë dhe në vitin 2019-2020 ajo zbriti me 24 vende dhe renditet në vendin e 82-të me 67.7 pikë. Për më tej vetëm disa skema kombëtare për ndarjen e kostove kanë vepruar për mbështetjen e grave sipërmarrëse të cilat e kanë zanafillën që nga vitet 2007-2008, por vlera e tyre është e vogël dhe nuk plotëson nevojat e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë, sidomos start-up-eve.

¹ INSTAT 2019, Regjistri i ndërmarrjeve 2018



DITA NDËRKOMBËTARE E PRONËSISË INTELLEKTUALE

Inovo për një të ardhme të gjelbër

Nga Albana Laknori

Çdo 26 Prill, festohet Dita Botërore e Pronësisë Intellektuale për të mësuar rreth rolit që luajnë të drejtat e Pronësisë Intellektuale (IP) në inkurajimin e inovacionit dhe krijimtarisë.

Dita Botërore e IP 2020 vendos risinë dhe të drejtat e IP që e mbështesin atë, në zemër të përpjekjeve për të krijuar një të ardhme të gjelbër. Pse? Sepse zgjedhjet që ne bëjmë sot do të formësohen nesër. Toka është shtëpia jonë. Duhet të kujdesemi për të. Fushata feston gjithashtu shumë shpikës, krijues e frymëzues në mbarë botën, të cilët po synojnë për një të ardhme të gjelbër - gra, burra dhe të rinj që janë duke punuar për alternativa teknologjike më të pastra të bazuara në lëndët djegëse fosile dhe sisteme më të mira e më të qëndrueshme të manaxhimit të burimeve natyrore e të ushqimeve, dhe që janë duke përdorur sistemin IP për të mbështetur punën e tyre dhe marrjen e përdorimit e tij në shoqëri.

Gdhendja e një shtegu për një të ardhme të gjelbër është thelbësore në ditët moderne. Të gjithë kemi vend në këtë sfidë dhe secili ka një rol në ndërtimin e një të ardhme të gjelbër. Është një përpjekje komplekse dhe me shumë aspekte, por siç ka vërejtur

natyralisti i mirënjohur David Attenborough, "*si specie, ne jemi zgjidhës problemesh*". Ne mund të krijojmë një të ardhme të gjelbër. Duhet të kemi mençurinë, zgjuarsinë dhe krijimtarinë kolektive të krijojmë mënyra të reja, më efektive për të formuar



një të ardhme me karbon të ulët. Por për këtë duhet të veprojmë tani!

Duhet të eksplorojmë se si një sistem IP i ekuilibruar dhe i fortë mund të mbështesë shfaqjen e një ekonomie të gjelbër që funksionon me dhe jo kundër sistemeve të mbështetjes së jetës në tokë.

Duhet të shikojmë se si sistemi i **patentave të shpikjeve** nxit inovacionin dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e teknologjive eko-miqësore që na mundësojnë të trajtojmë krizën e klimës dhe të ndërtojmë një të ardhme të gjelbër; si të drejtat e **dizenjove industriale** u mundësojnë projektuesve të investojnë kohën dhe talentin e tyre në krijimin e produkteve të dobishme,

tërheqëse dhe eko-miqësore për konsumatorët.

Duhet të konsiderojmë se si **markat tregtare** dhe identifikuesit e tjerë mbështesin shfaqjen dhe rritjen e bizneseve të bazuara në parimet e qëndrueshmërisë së mjedisit, duke u dhënë mundësi atyre të ofrojnë një gamë më të gjerë të produkteve dhe shërbimeve eko-miqësore.

Duhet të shohim se si të drejtat, siç janë **treguesit gjeografike** po inkurajojnë përdorimin më të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe si të drejtat e **mbarështimit të bimëve**, po promovojnë zhvillimin e kulturave më të qëndrueshme në mbështetje të sigurisë

globale të ushqimit.

Duhet të vëzhgojmë sesi krijuesit - të cilët përmes sistemit të të **drejtave të autorit** mund të fitojnë jetesën nga puna e tyre - mund të luajnë një rol kryesor në krijimin e një vizioni për një të ardhme të gjelbër dhe përfitimet e saj të paçmueshme.

Siç vërejtë Ajshtajni dikur, "*ne nuk mund të vazhdojmë të bëjmë të njëjtën gjë përsëri dhe përsëri dhe të presim rezultate të ndryshme*". Nëse duam rezultate të ndryshme, duhet të jemi inovues në qasjet tona, tek të menduarit dhe modelet tona të biznesit.

<https://www.wipo.int/ip-outreach/en/ipday/>

Inteligjenca Artificiale

Nga Ana Zacharian¹

Keni dëgjuar për Intelligjencën Artificiale? Natyrisht që po! E sidomos këto muajt e fundit gjatë pandemisë, "Inteligjenca Artificiale" është nga më të përmendurit falë zgjidhjeve të ndryshme teknologjike të ofruara prej saj kundër efekteve të virusit COVID-19. Sipas një artikulli të publikuar në faqet e Këshillit të Europës- Pasqyrë e bërë nga sekretariati i Komisionit Ad hoc për Intelligjencën Artificiale (CAHA)- "Inteligjenca artificiale (IA) është duke u përdorur si një mjet për të mbështetur luftën kundër pandemisë virale që ka prekur të gjithë botën që nga fillimi i vitit 2020. Shtypi dhe komuniteti shkencor janë duke i bërë jehonë shpresave të mëdha se shkenca e të dhënave dhe IA mund të përdoren për të përballuar koronavirusin dhe "mbushur boshllëqet" ende të mbetura nga shkenca".

Le t'i referohemi një shteti si Kina, epiqendra e parë e kësaj sëmundje dhe e njohur për përparimin e saj teknologjik në këtë fushë, është përpjekur ta shfrytëzojë këtë në avantazhin e saj. Përdorimet e saj duket se kanë përfshirë mbështetjen për masat që kufizojnë lëvizjen e popullatës, duke parashikuar evolucionin e shpërthimeve të sëmundjeve dhe hulumtime për zhvillimin e një vaksine ose trajtimi. Në lidhje me aspektin e fundit, IA është përdorur për të përshpejtuar renditjen e gjenomit, për të bërë diagnostikime më të shpejta, për të kryer analiza të skanerit ose, më shpesh, për të trajtuar robotët e mirëmbajtjes dhe shpërndarjes. Por masat e urgjencës duke përdorur zgjidhje teknologjike, përfshirë IA, gjithashtu duhet të vlerësohen në fund të krizës. Ata që çenojnë liritë

individuale nuk duhet të trivializohen me pretekstin e një mbrojtjeje më të mirë të popullatës.

Ky shembull na tregon qartë rëndësinë që kjo nënfushë e teknologjisë dhe informacionit po merr në situatat aktuale, por edhe shpjegon prirjen për të ardhmen.

Zotërimi i aftësive në Intelligjencën Artificiale renditet në aftësitë me të kërkuara të dy viteve të fundit dhe gjithashtu të dhjetëvjeçarit 2030.

Për të nxitur dhe promovuar njohjen e IA dhe aplikacioneve të saj në fusha të ndryshme të jetës, Albanian Skills - organizoi një seminar një javor nga Qendra e IA në Suedi, AI Center, për të rinjtë shqiptarë. Përgjatë një jave 20-24 Prill 2020, 55 të rinj studentë dhe profesionistë u njohën me konceptet dhe nocionet bazë të saj si edhe aplikimet në fusha të ndryshme. Pjesëmarrësve në seminar iu ngarkuan detyra praktike, si identifikimi i një situatë apo problemi të caktuar në fushat e tyre të punës apo studimit dhe propozimi i përmirësimit të asaj nëpërmjet IA.

18 prej këtyre pjesëmarrësve morën pjesë me propozimet e tyre duke i prezantuar gjatë ditës së fundit të seminarit. Qendra Suedeze IA, pas një mentorimi dhe vlerësimi të kujdesshëm të punimeve të pjesëmarrësve, po realizon certifikimin e tyre.

IA po evoluon vazhdimisht me qëllim që të përfitojnë prej saj shumë industri të ndryshme dhe aplikimet për inteligjencë artificiale janë të pafundme. Gjithashtu IA po testohet

dhe përdoret në industrinë e kujdesit shëndetësor për dozimin e medikamenteve dhe trajtimeve të ndryshme tek pacientët, dhe për procedurat kirurgjikale në sallën e operacionit.

Shembuj të tjerë të makinave me inteligjencë artificiale përfshijnë kompjuterët që luajnë shah dhe makinat vetë-drejtuese. Por, inteligjenca artificiale ka gjithashtu aplikime në industrinë financiare, ku përdoret për të zbuluar aktivitetin në bankë dhe financa siç është përdorimi i pazakontë i kartave të debitit dhe depozitat e mëdha të llogarive - të gjitha këto ndihmojnë departamentin e mashtimit të një banke. Aplikimet



për IA gjithashtu janë duke u përdorur për të ndihmuar në drejtimin dhe lehtësimin e tregtisë. Kjo bëhet duke e bërë më të lehtë vlerësimin e ofertës, kërkesës dhe çmimit të letrave me vlerë.

Të gjitha këto, janë arsye të mjaftueshme për të krijuar disa kushte dhe mjedis miqësor ndaj këtyre zhvillimeve premtuese të teknologjisë, pasi të rinjtë shqiptarë janë tepër të interesuar për këto aftësi të së ardhmes dhe investimi në këtë drejtim do të ishte gjëja e duhur për përgatitjen e kapitalit njerëzor për tregun vendas të punës por jo vetëm.

¹Presidente e AlbanianSkills, Eksperte në Arsim dhe Formim Profesional

Zvogëlimi i impaktit socio-ekonomik i COVID-19 përmes Udhëtimit dhe Turizmit

Nga Kujtime Stefani

Organizata Botërore e Turizmit (UNWTO) me kontributin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), sektori privat etj., ka përgatitur një dokument për rimëkëmbjen e sektorit të turizmit post COVID-19.

Udhëtimi dhe Turizmi është ndër sektorët më të prekur nga kjo emergjencë e paparë globale, dhe kërkohet mbështetje urgjente duke pasur parasysh miliona vende pune që janë në rrezik. Pra, kërkohen mbështetje urgjente dhe paketa specifike lehtësuese për të mbajtur vendet e punës dhe për të siguruar kapacitetet në treg pas pasojave të menjëhershme të emergjencës.

Për më tepër, COVID-19 do të ndikojë në vende të ndryshme në mënyra të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme. Aftësia e vendeve për t'u përgjigjur dhe për t'u rikuperuar nga kjo krizë e paparë gjithashtu do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme. Këto rekomandime synojnë të mbështesin qeveritë, sektorin privat dhe bashkësinë ndërkombëtare për të zbutur ndikimin e menjëhershëm të krizës në udhëtime dhe turizëm; ofrojnë stimul për rimëkëmbjen dhe drejtojnë zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të sektorit, duke u ndarë në tri grupe:

I. Menaxhimi i krizës & zbutja e ndikimit

Miliona jetë në të gjithë botën varen drejtpërdrejt dhe indirekt nga udhëtimi dhe turizmi. Si e tillë, këto masa janë me urgjencë maksimale dhe

duhet të zbatohen menjëherë, veçanërisht ato që lidhen me ofrimin e lehtësimit në kohë, të targetuar dhe të përkohshëm për njerëzit dhe firmat më të prekura për atë kohë sa zgjat urgjenca.

1. Stimulimi i ruajtjes së vendeve të punës, mbështetja e të vetëpunësuarve si dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël.
2. Suport për likuiditetin e ndërmarrjeve.
3. Rishikim për taksat, tarifën, detyrime të ndryshme si dhe rregulloret që ndikojnë në transport e turizëm.
4. Sigurimi i mbrojtjes dhe besimit të konsumatorit.
5. Promovimi i zhvillimit të aftësive, veçanërisht aftësive digjitale.
6. Të përfshihet turizmi në paketat e emergjencës ekonomike kombëtare, rajonale dhe globale.
7. Të hartohen strategji dhe mekanizma për manaxhimin e krizave.

II. Aplikimi i stimujve & përshejtimi i daljes nga kriza

Për shkak të rënies së papritur e të paparë të kërkesës, të shkaktuar nga pandemia COVID-19, sektori i udhëtimit dhe turizmit kërkon stimuj financiarë për të mbështetur rimëkëmbjen. Nivelet e stimulit të kërkuar mund të ndryshojnë në të gjithë zinxhirin e vlerës së turizmit.

8. Sigurimi i stimujve financiarë për investimet dhe operacionet në turizëm.
9. Rishikimi i taksave, tarifave dhe rregulloreve që ndikojnë në udhëtim dhe turizëm.
10. Lehtësim i avancuar për udhëtimet.
11. Promovimi i vendeve të reja të

punës dhe zhvillimi i aftësive, veçanërisht ato digjitale.

12. Krijimi i qëndrueshmërisë së mjedisit në paketat stimuluese dhe të rimëkëmbjes.

13. Studimi i tregut dhe veprimi i shpejtë për të rikthyer besimin dhe për të stimuluar kërkesën.

14. Zhvillim i gjerë i marketingut, eventeve dhe takimeve.

15. Rritja e bashkëpunimit dhe partneritetit.

16. Adresimi i Turizmit në programet e rimëkëmbjes kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare si dhe në Asistencën për Zhvillim.

III. Përgatitja për të nesërmen

Turizmi ka potencialin të rikuperohet dhe të vendoset edhe një herë si pjesë kryesore e ekonomive kombëtare dhe e agjendës më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Për më tepër, për të ndërtuar për të ardhmen, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet aftësisë ripërtëritëse të sektorit dhe promovimit të qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet.

17. Diversifikimi i tregjeve, produkteve dhe shërbimeve.

18. Investimi në sistemet e inteligjencës së tregut dhe transformimin digjital.

19. Forcimi i manaxhimit të turizmit në të gjitha nivelet.

20. Përgatitja për kriza, ndërtimi i aftësisë ripërtëritëse dhe të sigurohet që turizmi është pjesë e mekanizmit dhe sistemeve kombëtare të emergjencës.

21. Investimi në kapitalin njerëzor dhe zhvillimin e talentit.

22. Të këmbëngulet që zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit të futet në agjendën kombëtare.

23. Tranzicioni në ekonominë rrethore dhe përqafimi i SDG-ve.

<https://www.unwto.org/recommendations-for-recovery-covid-19>

FAKTE

25.7%

Biznese aktive të drejtuar/ pronare gra, për vitin 2018 në Shqipëri rezultojnë 25.7% me një ulje ↘ prej 4 pikë % krahasuar me 2017 (29.7%). (INSTAT, qershor 2019)



7.5%

Kredia për vitin 2019 rezulton me një rritje të ndjeshme prej 7,5% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, por përsëri më e ulët me 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e Shqipërisë, shkurt 2020)




Krahasimi Global i Paketave Stimuluese Koronavirus

Blokimet globale të vendosura prej javësh kanë shkaktuar trazira ekonomike. Situata i ka çuar qeveritë në gjendje krize dhe janë zhvilluar paketa stimuluese agresive për të parandaluar një kolaps katastrofik ekonomik global. Ceyhun Elgin, një profesor i ekonomisë në Universitetin Columbia, ka ndjekur përgjigjet në 166 vende të ndryshme. Sipas studimit të tij përgjigjet globale janë mjaft të ndryshme në krahasim me madhësinë ekonomike. Masat e SH.B.A.-së llogariten në rreth 13 % të PBB-së dhe qëndron në vend të dytë pas Japonisë masat e të cilës shkojnë në pak më shumë se 21 % të PBB-së. Në Evropë, ku Spanja dhe Italia patën shpërthimet më shkatërruese të koronavirusit, madhësia e paketave stimuluese vlerësohet të jetë përkatësisht 7.3 % dhe 5.7 % e PBB-së.

Global Coronavirus Stimulus Packages Compared

Financial response to the COVID-19 pandemic as a share of GDP (selected countries)*



* As of May 10, 2020
Source: Ceyhun Elgin



statista

www.statista.com

Kontribute për COVID-19

Komisioni Evropian mbledhi 8 miliardë dollarë (7,4 miliardë euro) nga zotimet e vendeve dhe donatorëve të tjerë, gjatë eventit "Përgjigjja Globale ndaj Koronavirusit". Nisma ishte e bashkë kryesuar nga Komisioni Evropian dhe 9 vende (përfshirë, veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen tha në një deklaratë zyrtare pas ngjarjes së të hënës se fondet do të përdoren për të adresuar tre nevoja më të ngutshme: përmirësimin e diagnostikimit, gjetjen e trajtimeve efektive dhe zhvillimin e një vaksine

World Leaders Pledge \$8 Billion to Fund COVID-19 Response

Initial contributions pledged by co-chairs of the Coronavirus Global Response Initiative



All figures have been converted to U.S. dollars and rounded to the nearest \$10 million
Source: European Union



statista

www.statista.com

Hapësirat e gjelbërta dhe autizmi

Nga Andela Malaj, Aurora Baba, NEUAR¹

Hapësirat e gjelbërta kanë pasur gjithmonë ndikim në shëndetin tonë mendor ashtu dhe në atë fizik. Gjithsesi, pak dihet në ditët e sotme rreth impaktit të këtyre hapësirave tek personat me autizëm, i cilësuar në nivel tashmë global si një nga çrregullimet neurologjike më të shpeshta që prekin fëmijët. Po çfarë është autizmi? Autizmi është një çrregullim kompleks i zhvillimit që shfaqet në mënyrë tipike në tre vitet e para të jetës dhe konsiderohet si një çrregullim neurologjik që prek funksionet e trurit. Bazuar në manualin statistikor të Organizatës Amerikane të Psikologjisë, çrregullimet e autizmit përfshijnë shumë fusha të zhvillimit: aftësinë për të ndërvepruar, aftësinë për të komunikuar si dhe krijimin e steriotipit në sjellje, interesa dhe aktivitete. Sipas teorisë së Bronfenbrenner themi se individët zhvillohen në bashkëveprim me mjedisin ku bëjnë pjesë. Një vëmendje të veçantë i kanë dhënë studiuesit e shumtë rrezikut mjedisor si një faktor që mund të shkaktojë autizëm. Të dhëna nga studimet tregojnë se përqindja e bebeve që lindin me autizëm është 8-10% më e lartë në rajone të ndotura me toksina sesa në ato që jetojnë në zona më të pastra (Kurtti, 2013)², gjithashtu një studim interesant është ai i kryer në vitin 2010 në Amerikë i titulluar "Marrëdhënia e Ndërsjellë midis Hapësirave të Gjelbërta dhe Autizmit në Fëmijët e Shkollave Fillore në Kaliforni"³ qëllimi i të cilit ishte të provonte nëse këto dy faktor, mjedisi dhe autizmi janë të lidhur me njëri-tjetrin. Pra a e shkakton autizmin mungesa e hapësirave të gjelbërta? A është ky një ndër faktorët që mund të cojë në zhvillimin e kësaj sëmundje? A ka prevalencë më të lartë të fëmijëve autik në zona ku hapësirat e gjelbërta janë më të vogla?

Për përgjigjen e këtyre pyetjeve studiuesit vendosën të shtrinin kërkimin e tyre në 560 shkolla publike në Kaliforni. Ata vendosën që të llogarisnin sipërfaqen e gjelbërt në të gjitha shkollat duke përfshirë dhe përqindjen pyjore, pemët e vogla dhe pemët e mëdha që ndodheshin në anë të rrugës gjithashtu dhe sipërfaqen e mbuluar nga bari. Studiuesit nga rezultatet e këtij hulumtimi arritën në përfundimin që rritja me 10% e hapësirave të gjelbërta ndikon drejtpërdrejt në një ulje prej 10% të numrit total të fëmijëve autik dhe me një ulje prej 19% të këtij numri nëse sasia e pemëve në anë të rrugës do të rritej me 10%. Ky binom midis autizmit-hapësirave të gjelbërta vërtetohet dhe një herë më shumë në shkollat të cilat ishin afër rrugëve kryesore. Zonat urbane me trafik të rënduar ishin të lidhura drejtpërdrejt me një rritje të numrit të fëmijëve autik. Hipoteza/Zgjidhja që këta studiues menduan që të implementonin pas këtij studimi ishte që të rrisnin numrin e pemëve pranë rrugëve kryesore duke e menduar si një 'Formë Parandalimi'. Por do duhen akoma shumë studime dhe prova të tjera që të konfirmojnë plotësisht këtë ndërlidhje midis kësaj patologjie dhe hapësirave të gjelbërta duke mos harruar që dhe ndotja akustike si pasojë e trafikut të rënduar mund të jetë një tjetër faktor ndikues tek fëmijët autik.

Në Shqipëri shohim një rritje të numrit të fëmijëve me autizëm nga viti në vit dhe sot sipas të dhënave nga Instituti i Shëndetit Publik, 1 në 68 fëmijë është i prekur nga autizmi. "Ne jemi duke folur për rreth 300 raste në çdo brez fëmijësh, nëse jemi në 30 mijë lindje të reja. Kjo do të thotë se jemi në 3 mijë, nëse marrim nga moshja 2-11 vjeç e nëse shkojmë nga 2 deri në 22 do të thotë se do të duhet të jemi në

numrin 6 mijë. Është një numër mjaft i madh krahasuar me atë që ndodh sot nëpër shërbimet tona, në pikëpamje të diagnostikimit. Edhe pse nga njëri 2-vjeçar në tjetrin prej 2010-ës dhe deri më sot, numri i rasteve të reja të diagnostikuara, shkon me 30-40% rritjeje çdo vit"-citon, shefi i Shërbimit të Psikiatrisë, Prof. Dr. Ariel Çomo⁴. Një shifër shumë alarmante duke marrë parasysh që është një patologji me të cilën ne kemi pak vite me të cilin jemi njohur dhe ballafaquar. Në Shtator 2008, është zhvilluar Konferenca e parë kombëtare shqiptare mbi autizmin, dhe kjo është e vetmja e dhënë që ne sot kemi sepse diagnostikimi dhe konfirmimi i pacientit të parë është i panjohur. Edhe pse shkaqet e vërteta që çojnë një fëmijë në autizëm ende nuk dihen, mund të themi se debati shtrihet në dy kahe, trashëgimi dhe mjedis. Nëse me trashëgimi kuptojmë atë pjesë të veçantë të kromozomeve që kombinohen në çastin e fertilizimit, kjo nënkupton se çdo gjë tjetër që ndodh më tej është mjedis. Hapësirat e gjelbërta në vendin tonë me kalimin e viteve janë përgjysmuar ose edhe më keq. Nuk mund të pohojmë pa një studim të hollësishëm nëse ky është një faktor ndikues në rritjen alarmante të numrit të fëmijëve autik në vendin tonë por mund ta lëmë si një hipotezë dhe një pikëpyetje të madhe me shpresë që t'i japim një përgjigje.

¹ **Bashkë-themeluese të Neuroscience for Urban Spaces and Architecture**

² <https://atunispottery.com/2013/11/24/autizmin-e-mesova-nga-ju-libri-me-i-fundit-i-autores-vera-kurtti-publikuar-nga-shtepia-botuese-ada/?fbclid=IwAR1cL1PFhEqCUTPu4nDBm3MKgLyDfggFNWv4FtrfpCtllMjxG072CriucC8>

³ https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC6104308/?fbclid=IwAR0ob-cuijpm87DjPxc_FKvimj6CHRJofGIL_FFstd5fhntqxtvubE_Vyy

⁴ <http://www.gsh.al/2018/04/04/alarmi-1-ne-68-femije-prekur-nga-autizmi/?fbclid=IwAR1MwJMbFaENJ6VNW0z26DqPq4YHX5SGWHYUzC4AuT813DPolxLJsQjO4>

Dita Botërore e Sklerozës Multiple

Nga Ina Pasho, Arlinda Demeti

Dita Botërore e Sklerozës Multiple (SM) përfaqëson fushatën vjetore për rritjen e ndërgjegjësimit mbi Sklerozën Multiple dhe për të mbështetur dhe krijuar lidhje mes 2,3 milion njerëzve që jetojnë me të në të gjithë botën. Është një ditë, dedikuar solidaritetit global dhe shpresës për të ardhmen.

Në vitin 2009, Federata Ndërkombëtare e Sklerozës Multiple inicioi Ditën e Parë Botërore të SM. Kjo ditë bën bashkë qindra mijëra njerëz në mbarë botën, me një fushatë që përqendrohet në një temë të ndryshme çdo vit.

Dita Botërore e SM është e përcaktuar zyrtarisht në 30 maj. Ajo bashkon komunitetin global të SM për të shkëmbyer histori, për të rritur ndërgjegjësimin, me dhe për të gjithë të prekurit nga Skleroza Multiple. Aktivitetet e Ditës Botërore të SM zhvillohen gjatë gjithë muajit maj dhe në fillim të Qershorit.

Tema e Ditës Botërore të SM 2020-2022 është *"Krijimi i Lidhjeve"* (connections). Këto kanë të bëjnë me ndërtimin e lidhjeve mes komunitetit, lidhjet personale dhe lidhjet me kujdesin shëndetësor cilësor, duke sfiduar barrierat sociale që i bëjnë njerëzit e prekur nga SM të ndihen të vetmuar dhe të izoluar nga shoqëria. Kjo datë ka disa vite që shoqërohet me aktivitete ndërgjegjësuese edhe në Shqipëri, të mbështetura nga kompania farmaceutike *Novartis*.

Por çfarë është Skleroza Multiple?

Skleroza multiple është një sëmundje që prek Sistemin Nervor Qendror, e karakterizuar nga inflamacioni, demielinizimi dhe ndryshime degjenerative, duke ndërprerë përçimin e informacionit dhe sinjaleve nervore ndërmjet trurit dhe funksioneve të tjera.

Skleroza Multiple shoqërohet me një nevojë të lartë të paplotësuar terapeutike, e cila lidhet me progresionin dhe shprehet me rritje të aftësisë së kufizuar, mungesës së trajtimeve efektive dhe rritjes së nevojave fizike dhe psikosociale. Pacientët me SM kanë një humbje të madhe të lëvizshmërisë, dëmtim të rëndë konjektiv, si dhe probleme me kujtesën, lodhje dhe dhimbje. Një përqindje e lartë e pacientëve me SM gjithashtu përjetojnë depresion dhe disfunkcion seksual, çrregullim të funksionit të zorrëve dhe fshikëzës së urinës. Të gjitha këto simptoma kanë një ndikim të thellë në jetën e pacientëve, duke reduktuar pavarësinë dhe aftësinë e tyre për të kryer detyrat e përditshme dhe duke shkaktuar çrregullime emocionale. Për rrjedhojë, pacientët me SM kanë përkeqësime të konsiderueshme të cilësisë së jetës.

- ✓ 86% e pacientëve nuk shkojnë më në shkollë apo në punë
- ✓ 68% e pacientëve nuk marrin pjesë në aktivitetet sociale dhe familjare
- ✓ 71% kanë nevojë për përkujdesje
- ✓ 50% e pacientëve paraqesin dëmtime konjiktive
- ✓ Kosto të larta që lidhen direkt dhe jo-direkt me mjekimin
- ✓ Kosto të larta për shoqërinë dhe familjen

Fatkeqësisht, ende ka një numër të paktë të barnave të miratuara për trajtimin e SM, ndër të cilat dhe një pjesë e mirë e tyre nuk janë efektive në trajtimin e pacientëve, duke mos ngadalësuar progresionin. Kjo tregon një nevojë të madhe të pambuluar për trajtimin në mënyrë efektive të pacientëve.



Në vendin tonë, mundësia e trajtimit vetëm në një qendër të trajtimit të SM, fakti se mjekët që merren me diagnostikimin, trajtimin dhe manaxhimin e pacientëve janë shumë të kufizuar në numër si dhe largësia dhe distanca, e bëjnë më të vështirë mirëmanaxhimin e sëmundjes, prandaj krijimi i mundësive të reja për manaxhimin dhe trajtimin e SM bën të mundur lehtësimin e këtij rrugëtimi duke lehtësuar barrën e pacientit, familjarëve dhe të mjekëve.

Pacientët të cilët ndjekin kontrollet rutinë, 2-5 vite nga diagnostikimi fillestar humbasin besimin se ata po marrin trajtimin e duhur për sëmundjen e tyre.

Çdo pacient është unik, dhe rrugëtimi i tij është unik. Fokusimi dhe targetimi i proceseve inflamatore dhe neurodegenerative, selektiviteti, profili i sigurisë janë kriteret e kërkuara për terapitë efektive.

Produkte të reja apo në faza studimi po japin një shpresë në këtë drejtim, duke synuar lehtësimin e simptomave të sëmundjes, frenimin e progresit të saj si dhe duke iu mundësuar këtyre pacientëve rifitimin e pavarësisë.

[Multiple Sclerosis International Federation](#)

[Multiple Sclerosis: Just the facts. National Multiple Sclerosis Society; 2018](#)

NPM-27/05/2020-AL2005277743

Rruga "Hoxha Tasim", Nr. 23,

Tirana, Albania

Tel: +355 4 2232444

E-Platform

Nga Erjona Rebi, PhD

SHGPAZ në kuadër të zbatimit të projektit *"Nxitja e Sipërmarrjes dhe të Mësuarit mbi Sipërmarrjen tek të Rinjtë dhe Gratë në Shqipëri"*, të financuar nga BE-ja nëpërmjet CFCU (Njësia Qendrore e Financimit dhe Koordinimit) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgatiti E-platformën për Gruan Sipërma-rrëse dhe për të Mësuarit mbi Sipërmarrjen.

Në këtë platformë njëra shtyllë i kushtohet *"Gruas Sipërmarrëse"*, ku do të gjeni informacionet më të fundit për ecurinë e zhvillimit të sipërmarrjes femërore në Shqipëri në vite, informacione të nevojshme për gratë sipërmarrëse për programet/grantet si dhe për mundësi kreditimi. Më tej politik-

bërësit do të gjejnë eksperiencat më të mira rajonale dhe europiane, për programe e grante për të nxitur zhvillimin e gruas sipërmarrëse.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme në këtë platformë është ajo *"për të Mësuarin për Sipërmarrjen"*, e cila do t'iu shërbejë mësuesve e pedagogëve si edhe politik-bërësve pranë Ministrisë së Arsimit për kurrikulat mbi sipërma-rrjen dhe eksperiencat më të mira rajonale e sidomos ato të Kroacisë për të hartuar programet mësimore dhe për të trajnuar mësuesit si *"mësues sipërmarrës"*, e shkollat si *"shkolla sipërmarrëse"*.

Këtë platformë mund ta gjeni në adresën: www.shgpaz.al/eplatform

KONSULENCË LIGJORE PËR PRONËSINË INTELEKTUALE

MARKAT TREGTARE, PATENTAT E SHPIKJEVE, E DREJTA E AUTORIT

Ofrojmë mbrojtje, konsulence tekniko-shkencore dhe ligjore, si për individët dhe bizneset që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj:

Na kontaktoni në çdo kohë në:

Albana LAKNORI
Sekretare e Përgjithshme e DHTI
Tiranë
Mob:+355693410000,
Tel:+35545800935
e-mail: albana_laknori@cci.al;
albanalaknori@gmail.com
website: www.cci.al

Shënim: Opinionet e paraqitura në buletin janë ato të vetë ekspertëve dhe nuk paraqesin opinionin e BE-së

Buletin
Informativ

Maj 2020

www.shgpaz.al

fb:facebook.com/shgpaz

email:info.shgpaz@yahoo.com



Përgatitur nga:

Msc. Flutura XHABIJA &
Msc., MA Arlinda DEMETI
&Redaksia